REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE DHE SHERBIMI SOCIAL

Nr.102/1 Prot

Pustec më 21.01.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr.3 Datë 21.01.2026

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT SOCIAL TË BASHKISË PUSTEC 2026-2030

Në mbështetje të neneve 18, 24, 54 dhe 55, si dhe nenit 13, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", veçanërisht neni 73, pika 2, shkronja "b", i cili parashikon kompetencat e këshillit bashkiak për miratimin e programeve të strehimit social; Duke u mbështetur në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë fushën e strehimit social, mbrojtjen e shtresave në nevojë dhe garantimin e të drejtës për strehim të përshtatshëm; Duke marrë në konsideratë nevojën për planifikim afatmesëm dhe afatgjatë të politikave vendore të strehimit social, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për familjet dhe individët në nevojë, si dhe garantimin e një qasjeje të drejtë, transparente dhe të qëndrueshme në ofrimin e zgjidhjeve të strehimit. Kryetari i Bashkisë Pustec me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, i propozon Këshillit të Bashkisë

TË MIRATOJ

1. Miratimin e Programit 5-Vjeçar të Strehimit Social të Bashkisë Pustec për periudhën 2026–2030, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Programi synon identifikimin e nevojave për strehim social, përcaktimin e kategorive përfituese, planifikimin dhe zbatimin e instrumenteve të strehimit social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përgjegjëse të administratës bashkiake për zbatimin e këtij vendimi dhe të Programit 5-Vjeçar të Strehimit Social, në përputhje me legjislacionin në fuqi
4. Ky projektvendim i paraqitet Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim dhe hyn në fuqi pas miratimit dhe shpalljes sipas procedurave ligjore.

Marjeta Serbin Specialist i NE dhe Strehimit_____
Para Trajko Specialist PAK, drejtat e fëmijeve,_____

KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC

Adresa : Pustec, Korçë Tel. 0035586792012 e-mail : bashkia.pustec@gmail.com